

**SHOQËRIA "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE" SH.A**  
**ADRESA: RR. "MUHAMET GJOLLESHA", TIRANË**  
**NUIS J61807025P**

Tiranë, më 11.11.2021

**DEKLARATË E ADMINISTRATORIT**  
**Për korrigjimin e Deklaratës/Njoftimit për realizimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë të datës 02.11.2021**


Unë, e nënshkruara Ajola Xoxa, në përgjegjësinë ligjore të funksionit të Administratorit të shoqërisë "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE" SH.A, (këtu e në vijim "Shoqëria"), me seli në rrugën "Muhamet Gjollesha", Tiranë, Shqipëri, deklaroj se:

Më datë 21.06.2021, në orën 10:00, është mbledhur rregullisht Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE" SH.A, e cila ka vendosur, ndër të tjera, zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, nëpërmjet emetimit të 16.000 (*gjashtëmbëdhjetë mijë*) aksioneve të reja, me vlerë nominale 1.000 (*një mijë*) Lekë secili, me vlerë totale të barabartë me 16.000.000 (*gjashtëmbëdhjetë milion*) lekë.

Aksionari që ushtroi të drejtën e parablerjes, ka qenë znj. Valbona Xhemil Xoxa, e cila ka kaluar pjesën e saj takuese me një vlerë të barabartë me 6.170.667 (*gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë*) Lekë.

Duke qenë se vlera e paguar nga aksionarja që ka ushtuar të drejtën e parablerjes është 6.170.667 (*gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë*) Lekë, numri i aksioneve që i korrespondon kësaj shifre është 6.170,667 (*gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë presje gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë*) aksione, numër i cili është rrumbullakosur në 6.171 (*gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një*) aksione për efekt regjistrimi në QKB.

Meqenëse vlera e paguar nga aksionarja znj. Valbona Xoxa, në kuadër të procedurës për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë, është 6.170.667 (*gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë*) Lekë, kapitali i Shoqërisë është rritur nga 6.000.000 (*gjashtë milion*) milion në 12.170.667 (*dymbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë*) Lekë. Kjo shifër prej 12.170.667 (*dymbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e shtatë*) Lekë duke qenë se është një shifër e pa rrumbullakosur, së cilës nuk i korrespondon një numër i plotë aksionesh, ka bërë që vlera nominale e secilit aksion të ulet nga 1.000,00 (*një mijë presje zero zero*) Lekë në 999,97 (*nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë e shtatë*) Lekë. Kjo ulje e vlerës nominale bie ndesh edhe me vetë vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të datës 21.06.2021, si dhe me Deklaratën/Njoftimin për realizimin e zmadhimit të kapitalit të datës 02.11.2021, ku shprehimisht parashikohet që aksionet e reja të emetuara nga Shoqëria kanë vlerë nominale prej 1.000 (*një mijë*) Lekë secili.



Në këto kushte, me qëllimin për të respektuar dhe për të qenë në përputhje me atë çka është vendosur më herët lidhur me zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë, deklaroj se vlera prej 667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë, e cila nuk përkthehet në një aksion të plotë në vetvete, do t'i kthehet mbrapsht znj. Valbona Xoxa, duke bërë të mundur rumbullakosjen e aksioneve të saj në 6.170 (gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) aksione të reja, të cilave i korrespondon shuma finale e paguar prej saj prej 6.170.000 (gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë) Lekë. Në këtë mënyrë kapitali i Shoqërisë pas realizimit të zmadhimit është 12.170.000 (dymbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë) Lekë, e cila bën të mundur që vlera nominale e secilit aksion të jetë e barabartë me 1.000 (një mijë) Lekë, në përputhje me vendimarrjen e vetë Shoqërisë.

Me anë të kësaj Deklarate kërkoj të korrigjoj Deklaratën/Njoftimin për realizimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë, të datës 02.11.2021, duke kërkuar njëkohësisht saktësimet e mëposhtme në ekstraktin e regjistrit tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit:

1. Zëri kapitali të ndryshohet nga 12.170.667,00 (dymbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje zero zero) në 12.170.000,00 (dymbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë presje zero zero);
2. Zëri vlera e kapitalit të shlyer të ndryshohet nga 12.170.667,00 (dymbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje zero zero) në 12.170.000,00 (dymbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë presje zero zero);
3. Zëri vlera nominale të ndryshohet nga 999,97 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë e shtatë) në 1.000,00 (një mijë presje zero zero) Lekë;
4. Pasqyrimin e rritjes së aksioneve të znj. Valbona Xoxa nga 6.171 (gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një) aksione në 6.170 (gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) aksione, duke e çuar në total numrin e aksione të zotëruara prej saj në 8.484 (tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) aksione në total;
5. Pasqyrimin në sistemin elektronik të QKB-së të të dhënave të listave që shoqërojnë këtë Deklaratë.

Bashkëlidhur kësaj deklarate, gjenden:

- Lista e aksionarëve të shoqërisë së bashku me numrin e aksioneve të zotëruara prej tyre, si dhe pjesëmarrja e tyre në shoqëri pas realizimit të zmadhimit të kapitalit;
- Lista e aksionarëve që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumën e paguara prej tyre;
- Mandat pagesa që vërteton kthimin e shumës prej 667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë në llogarinë bankare të aksionares Valbona Xoxa.

Për "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE" SH.A.

Administrator

Znj. Ajola Xoxa